



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1575 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

VENDIM Nr. 247, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30 dhe 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të projektit "*Godinë shërbimi 2 kate në sheshin publik para hyrjes së portit*", buzë shëtitorës "Taulantia" i cili *pozicionohet jashtë zonifikimit arkeologjik të qytetit të Durrësit*-subjekti Shaban Dedej, Sami Dedej dhe Laureta Tragaj, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të projektit "*Godinë shërbimi 2 kate në sheshin publik para hyrjes së portit*", buzë shëtitorës "Taulantia" i cili *pozicionohet jashtë zonifikimit arkeologjik të qytetit të Durrësit*-subjekti Shaban Dedej, Sami Dedej dhe Laureta Tragaj, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekreturia.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al